



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:276906

Datë: 09.07.2024

Numri i dokumentit: 05917372

K.Dh.Sh.II.nr.916/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit “Energy Development Group - Kosova” L.L.C me seli në Madanaj, Gjakovë te cilin e përfaqëson Vegim Kraja avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.566/23, të datës 14.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, e datës 25.03.2024.

II. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.566/23, i datës 14.03.2024,

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Energy Development Group - Kosova” L.L.C Anulohen Vendimi Nr.6562/01-KOM i datës 06.11.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimi Nr. 710 i datës 15.09.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë pranë të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. II. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. III. Shtyrja e ekzekutimit të Vendimit Nr.6562/01-KOM i datës 06.11.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit Nr. 710 të datës 15.09.2023 i nxjerrë nga Zëvendës Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë - Ministria e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.566/23 i datës 13.12.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes përfaqësueses Avokaturës Shtetërore, ka ushtruar ankesë për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e të paditurit Shoqëria Tregtare “Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Agjencia e Regjistrimit të Biznesit, në tërësi e bazuar, ndërsa Aktgjykimi i shkallës së parë ta prish dhe çështja t’i kthehet të njëjtës në rigjykim dhe rivendosje dhe të mbetet në fuqi vendimi 6562/01 – KOM i datës 06.11.2023 nga K/01-KOM i Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Agjencia e Regjistrimit të Biznesit.

Paditësi në përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2024 i propozon gjykatës që të refuzohet ankesa e të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me seli në Prishtinë si e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi Aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës.

Gjykata e Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.6562/01-KOM të datës 06.11.2023, ka refuzuar ankesën e parashtruar nga Shoqëria Tregtare “Energy Development Group - Kosova” me adresë Gjakovë dhe ka lënë në fuqi vendimin e ARBK-së me numër 710 të datës 15.09.2023.

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur, ushtron padi në gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me dt.22.02.2024, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, si të bazuar dhe e anulon vendimin me shifrën 6562/01-KOM i datës 06.11.2023 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vendimin nr.710 i datës 15.09.2023 i nxjerr nga drejtoria e Përgjithshme e Agjencizë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, duke vendosur decizivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se gjykata gjeti se i padituri gabimisht ka aplikuar dispozitat e LSHT duke shfuqizuar në mënyrë arbitrare certifikatën e biznesit të paditësit “Energy Development Group - Kosova” SH.P.K., kjo për faktin se drejtori i përgjithshëm i ARBK kishte tejkualuar kompetencat me rastin e nxjerrjes së vendimit për shfuqizimin e certifikatës së biznesit të paditësit, pasi që paditësit i janë vendosur kushte apo kufizime të cilat nuk gjejnë mbështetje ligjore në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe nuk ka paraparë dispozita ligjore të cilat i lë në diskrecion drejtorit të ARBK, të shfuqizoj certifikatën e bizneseve të regjistruara. Duke qenë se asnjë dispozitë ligjore nuk përcakton mundësinë e shfuqizimit të

certifikatës së biznesit, gjykata vlerëson se për nga efekti që jep vendimi i nxjerrë nga i padituri në procedurë administrative, i pamundëson shoqërisë tregtare vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, përkatësisht ka për pasojë pushimin e veprimtarisë ekonomike. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se personi juridik mund të shuhet, përkatësisht personit juridik mund t'i përfundonte veprimtaria ekonomike sipas përcaktimit në statut, aktin themelues apo mbi bazën e ligjit, ashtu që mbi bazën e ligjit personi juridik mund të çregjistrohet, mund të shpërbëhet në mënyrë vullnetare përmes inicimit të procedurës së falimentimit vullnetarë, mund të shuhet përmes inicimit të procedurës së falimentimit jo vullnetar si dhe mund të shuhet si pasojë e kryerjes së ndonjë vepre penale. Tutje është theksuar se Gjykata, po ashtu konstatoi se i padituri në vendimin e shkallës së parë dhe në vendimin e shkallës së dytë i është referuar nenit 57 par.2 të LPPA-së si bazë ligjore për shfuqizimin e certifikatës së biznesit së paditësit, e cila dispozitë përcakton se: “2. Përpos nëse parashihet ndryshe me ligj, një akt administrativ dobiprurës i ligjshëm, mund të shfuqizohet vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, dhe kjo nuk do të mund të bëhet në mënyra tjera që do të cenonin më pak të drejtat apo interesat juridike të fituara të palës.”. Gjykata vlerëson se i padituri duke shfuqizuar certifikatën e biznesit të paditësit ka bërë zbatim të gabuar të nenit 57 par.2 të LPPA-së pasi që shfuqizimi nuk ka qenë i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike. Përveç kësaj, i padituri do të obligohej që në kuptim të par. 3 dhe 4 të nenit 57 të LPPA-së të bënte kompensimin monetar për dëmet e shkaktuara nga marrëdhënie juridiko-civile nga të cilat nuk mund tërhiqet më paditësi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Dytë, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkalles së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje

qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar nenit 4 të LPPA-së ku përcaktohet se *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj...”*

Kolegji, po ashtu vlerëson se të gjeturat e Gjykatës së shkallës së parë janë të drejta dhe të bazuara sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, kur vendimin e saj e mbështet edhe në nenin 52 të LPPA-së i cili përcakton se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit”*, ku rrjedhimisht është konstatuar se Vendimit Nr.6562/01-KOM i datës 06.11.2023 dhe Vendimi Nr. 710 i datës 15.09.2023 të nxjerra nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, duhet të anulohen pasi që të njëjtat janë nxjerrë në mungesë të kompetencës, në kundërshtim me ligjin material dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, pasi që e paditura ka nxjerr vendim konform kompetencës duke refuzuar ankesën e paditësit, i cili ka shqyrtuar dosjen e paditësit dhe nga provat e lëndës ka vërtetuar se në historinë e regjistrimeve dhe ndryshimeve të kësaj shoqërie tregtare është përdorur dokumenti i identifikimit nga Republika e Serbisë ku në pjesën e vendit të lindjes është shënuar Serbia, ky ID i përdorur përmban të dhëna të pasakta sepse përcaktimi i qytetit nuk është sipas organizimit dhe strukturës së qyteteve të komunës së Republikës së Kosovës. Këtë pretendim kolegji i kësaj gjykate e konsideron si të pabazuar pasi që kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në rastet e cenimit të rendin juridik të Republikës së Kosovës nga një person juridik, duhet të veprohet në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, në bazë të cilit ligj një shoqërie tregtare mund t'i shqiptohen sanksionet e përcaktuara me këtë ligj e që përfshinë edhe pushimin e personit juridik në rast të plotësimit të kushteve të përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji. Prandaj, gjykata vlerëson se duke qenë se vetë ARBK kishte toleruar - aprovuar regjistrimin e ndryshimeve me informata të tilla, është dashur të ndjek procedurën për korrigjim të gabimeve në shoqërinë të cilat janë regjistruar ato gabime dhe në asnjë formë nuk ka pasur bazë ligjore që të bëjë shfuqizimin e certifikatës së biznesit, veprim ky po ashtu në kundërshtim me nenin 8 par.1 të LPPA-së i cili përcakton se: *“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe*

të arsyeshme të personave.” pasi që në rastet kur tolerohet–aprovohet një veprim nga organi administrativ, pasojat duhet të jenë të parashikueshme dhe në kuadër të pritshmërive ligjore dhe në asnjë formë me veprime që nuk gjejnë bazë ligjore. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.916/24 i datës 04.07.2014

Kryetare i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.